



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 101/ 2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Ferizaj, paraqitur kundër, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Ferizaj, për shkak ndikimit të votueseve gjatë ditës së votimit, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

**VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa, e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se anëtarët e subjektit politik PDK, gjatë ditës së zgjedhjes për kryetar të Komunës së Ferizajt, kanë kërcënuar dhe i kanë shtyrë të votojnë pjesëtarët e minoritetit Ashkali të fshatit Dubravë , si dhe sipas pretenduesit të ankesës personat në fjalë janë bartur nga ky subjekt politik me vetura dhe kombi busa në mënyrë të dhunshme.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi.

PZAP-i, me datë 30.04.2012 në mënyrë elektronike bëri kërkesë për raport policor, në stacionin policor në Ferizaj, lidhur me verifikimin e pretendimeve në ankesën Anr. 101/2012, të paraqitur nga subjekti politik LDK, të datës 30.04.2012, si dhe kërkoi që përgjigja për rastin konkret për shkak të afateve të shkurtra ligjore, të bëhet deri me datë 02.05.2012.

PZAP-i, me datën 02.05.2012, në mënyrë elektronike mori përgjigjen e raportit policor nga policia e Kosovës në Ferizaj në të cilin theksohet se me datë 02.05.2012, është kontaktuar me ankuesin Faruk Guri përfaqësues i partisë politike LDK, në lidhje me ankesën e tij Anr. 101/2012, se në ditën e zgjedhjeve me datë 29.04.2012,

sipas pretenduesit të ankesës, përfaqësuesit PDK-së, kanë bartur me vetura pjesëtarët e minoritetit Ashkali, për të votuar për këtë subjekt politik në mënyrë të dhunshme. Me tutje në raportin policor theksohet se është intervistuar z.Guri, mirëpo nuk ka qenë në gjendje të jap asnjë informatë konkrete në lidhje me rastin si dhe nuk ka dijeni se cilat ishin targat e tabelave, cilët ishin emrat e personave të cilët janë bartur ose kanosur, e po ashtu nuk ka njohuri se kush ka raportuar përveç që thotë se e ka dëgjuar këtë informatë nga persona që ishin në zyrën e tij. Po ashtu në raportin policor theksohet se është hetuar rasti edhe në fshatin Dubravë, si dhe është bërë kontaktimi i banoreve të këtij lokaliteti, nga policët hetues, në lidhje me këtë informatë, mirëpo është ardhur në përfundim se të gjithë personat e pyetur nga policia e Kosovës kanë deklaruar që ata kanë shkuar të votojnë më dëshirë si dhe disa kanë shkuar me veturat e tyre private e disa këmbë për arsye se vendi ku është dashur të votojnë ka qenë afër, përfundon në raportin policor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga ankesa e parashtruar në PZAP, nuk mund të konstatohen pretendimet ankimore, ngase parashtruesi i ankesës, nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë, si dëshmi për të u bindur se ka ndodhur ndikim tek votuesit për të votuar në mënyrë të dhunshme, andaj PZAP-i, duke u bazuar në raportin policor, të lartë përmendur si dhe në shkresat e lëndës gjeti se pretendimet ankimore në ankesë nuk qëndrojnë për faktin se pretendimet e tilla ankimore, nuk janë të bazuara në dëshmi të qarta dhe bindëse, duke marr parasysh këtë, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazuar, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr.101/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

